



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:242651

Datë: 10.09.2024

Numri i dokumentit: 06141153

C.nr.390/2019

PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE

I përpiluar më datë 10.09.2024, në GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit - Prishtinë të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.G. kundër të paditurit A.I. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Kushtrim Salihu, me objekt kontesti rimbursim dëmi.

P r e z e n t:

Gjyqtari:
Leotrim Gashi

Për paditësen
B.G. sipas autorizimit

Për të paditurin:
Personalisht A.I.
Av. K.S.

Zyrtare ligjore
Liridona Bajrami

Pyeten palët se a kanë vërejtje në përbërjen e gjykatës:

Pa vërejtje nga palët.

Seanca është publike

Filloj ne ora 10:30, për shkak të një seance paraprake.

Gjyqtari i çështjes e hap shqyrtimin mbi këtë çështje, e publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në këtë seancë prezent është përfaqësuesja e autorizuar i paditëses, i padituri A.I. si dhe përfaqësuesi i të paditurit av. K.S.

Andaj gjykata konstaton se ka kushte ligjore për mbajtjen e seancës, e si rrjedhojë merr:

A K T V E N D I M

Seanca e sotme mbahet dhe e njëjta është publike.

Gjykata i njofton palët prezente se duhet të mbajnë rendin dhe qetësinë në gjykatë dhe nuk duhet të flasin derisa gjykata të iu jap fjalën, për prishje të rendit dhe qetësisë në seancë gjyqësore, gjykata mund që duke u bazuar në nenin 289.2 të LPK-së, fillimisht do t'i qortoqë palët dhe nëse kjo rezulton të jetë e pasuksesshme mundet që ti largoj nga salla dhe t'iu shqiptojë gjobë deri në 500 euro.

Gjykata i njofton palët së në këtë seancë përgatitore duhet të parashtrojnë të gjitha faktet në të cilat mbështesin kërkesat e tyre si dhe të propozojnë të gjitha provat më të cilat pretendojnë të vërtetojnë faktet e tilla.

Gjykata i njofton palët se kontestin mund ta zgjidhin edhe në procedurën e ndërmjetësimit, në pajtim me nenin 411 të LPK – së si dhe me anë të pajtimit gjyqësor siç parashihet në nenin 412 të LPK – së.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit përfaqësuesja e paditësit, deklaron:

I propozojmë gjykatës që kjo çështje të mbyllet me pajtim gjyqësor duke ia mundësuar të paditurit pagesën me këste, po ashtu heqi dorë nga kamata dhe shpenzimet e procedurës.

Po ashtu, dua ta përmirësoj thëniet e padisë, ashtu që në padi është theksuar se në aksidentin e datës 17.04.2017, si palë e dëmtuar është “Xeni Group” mirëpo kjo palë e dëmtuar është përfshirë gabimisht në padi sepse i njëjti nuk është i dëmtuar i këtij aksidenti e as nuk është kompensuar.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit i përfaqësuesi i të paditurit deklaron:

Ne nuk e kundërshtojmë pajtimin gjyqësor të propozuar në këtë seancë nga përfaqësuesja e paditëses, pasi që i padituri, pas konsultimit me të, i njëjti e pranon këtë propozim për marrëveshje nga ana e paditësit për shumën e cekur në këtë padi si dhe për faktin se paditësja heq dorë nga kamata ligjore dhe shpenzimet e procedurës.

Palët ndërgjyqëse deklarojnë se kanë arritur pajtim gjyqësor dhe i propozojnë gjykatës që ta aprovojë këtë:

PAJTIM GJYQËSOR

- I. DETYROHET i padituri A.I. , që në emër të shkaktimit të dëmit, në aksidentin e datës 17.04.2017, t'ia paguajë paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit shumën prej 2,282.00 euro në 22 këste mujore, ashtu që në 21 muaj (këste) të paguajë shumën prej 100.00 euro, kurse në këstin e fundit shumën prej 182 euro, duke filluar nga data 20 deri në 30 të çdo muaji dhe atë nga muaji tetor 2024 e deri në përmbushjen totale të detyrimit, e cila shumë duhet të paguhet në xhirollogarinë e paditëses me numër---, në Bankën Private të Biznesit (BPB).
- II. Paditësja heq dorë nga shpenzimet e procedurës dhe nga kamata ligjore.

Gjykata në bazë të nenit 411 dhe 412 të LPK –së, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pajtimi gjyqësor, i lartpropozuar nga ana e palëve ndërgjyqëse.
- II. Ky pajtim paraqet titull ekzekutiv dhe mund të goditet vetëm me padi.

Procesverbali pasi u dëgjua me zë i njëjti edhe u nënshkrua pa vërejtje.

Përfundoi në ora minuta.

Përfaqësuesja e paditëses

I padituri

Përfaqësuesi i të paditurit

Vërtetojnë

Zyrtarja ligjore

Gjyqtari